



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 213

Tiranë – E hënë, 7 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 4.12.2020	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm..... 16393
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 971, datë 2.12.2020	Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë..... 16400
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 2.12.2020	Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë..... 16401
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 975, datë 2.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar..... 16406
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 25, datë 1.12.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 16408
	Ndreqje gabimi në vendimin nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organizimit dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë punë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193/2020, datë 9.11.2020..... 16409

**VENDIM****Nr. 970, datë 4.12.2020**

**PËR MIRATIMIN E
METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN
E VLERËS SË SENDIT NË PROCESIN E
EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit 2, të nenit 564, të Kodit të Procedurës Civile, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë dhe përmbartuesit gjyqësorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**METODOLOGJIA
PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË SENDIT
NË PROCESIN E EKZEKUTIMIT TË
DETYRUESHËM**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj metodologjie është përcaktimi i metodave të vlerësimit për llogaritjen e vlerës së sendeve të paluajtshme, mjeteve të lundrimit dhe mjeteve të fluturimit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj metodologjie është garantimi i rregullave dhe i mënyrave për vlerësimin e sendit

të paluajtshëm, mjetit të lundrimit apo mjetit të fluturimit, duke përcaktuar në këtë mënyrë bazën për përcaktimin e çmimit eventuel të shitjes, për efekt të procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë.

**Neni 3
Përkufizime**

Në kuptim të kësaj metodologjie, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Send i sekuestruar” përfshin sendet e paluajtshme, mjetet e lundrimit dhe mjetet e fluturimit në pronësi të debitorit ose të personit që ka të drejta reale mbi sendin, mbi të cilët vendoset sekuestro nga përmbartuesi gjyqësor për ekzekutimin e vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë;

b) “Send i paluajtshëm”, toka dhe të gjitha elementet që janë pjesë e natyrshme e tokës, si për shembull: pemët, mineralet dhe elemente të tjera të bashkëngjitur me tokën, si për shembull: ndërtesat, përmirësimet e truallit, si dhe instalimet e përhershme të ndërtimit, pajisjet mekanike dhe elektrike të një ndërtese, të cilat mund të jenë nën ose mbi tokë;

c) “Vlera e tregut”, shumta e vlerësuar për të cilën një send do të shkëmbehej në datën e vlerësimit, midis një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm, në një transaksion normal, pas një marketingu të përshtatshëm, në të cilin palët kanë vepruar secili në mënyrë të mirinformuar, të kujdesshme dhe pa detyrim;

ç) “Vlera e skrapit”, vlera e tjetërsimit të një sendi të sekuestruar, në rastet kur është i dëmtuar dhe i papërdorshëm;

d) “Kostoja zëvendësuese e amortizimit”, kostoja aktuale e zëvendësimit të një aseti me një aset modern ekuivalent minus zbritjet për dëmtimin fizik dhe të gjitha format e vjetërimit dhe të optimizimit;

dh) “Kostoja e makinerive dhe e pajisjeve që kualifikohen për njohje si aset”, çmimi kesh ekuivalent i artikullit në datën e vlerësimit dhe përfshin çmimin e tij të blerjes, taksat doganore dhe taksat e pakompensueshme të blerjes, pasi të jenë zbritur skontot tregtare;



e) “Jeta ekonomike e ndërtesës”, periudha gjatë së cilës ndërtesa kryen funksionin për të cilën është projektuar;

ë) “Jeta e përdorimit të ndërtesës”, periudha gjatë së cilës ndërtesa është përdorur nga data e ndërtimit dhe kryerjes së funksionit për të cilin është projektuar deri në datën e vlerësimit;

f) “Ekspert i licencuar”, personi që ka licencë profesionale në fushën e vlerësimit të sendeve, sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

g) “Data e vlerësimit”, data në të cilën zbatohet opinioni i vlerës. Data e vlerësimit duhet të përfshijë edhe orën që zbatohet, në qoftë se vlera e këtij lloji aktiviteti mund të ndryshojë ndjeshëm në rrjedhën e një dite të vetme.

Neni 4

Parimet

Për përcaktimin e vlerës së sendit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, përmbartuesi gjyqësor udhëhiqet nga parimi i:

- a) mbrojtjes dhe i garantimit të së drejtës së pronësisë;
- b) ligjshmërisë;
- c) respektimit të standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive;
- ç) drejtësisë dhe paanësisë;
- d) transparencës;
- dh) bashkëpunimit me persona juridikë dhe fizikë;
- e) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve.

Neni 5

Eksperti

1. Përmbartuesi gjyqësor cakton një ekspert të licencuar të fushës për vlerësimin e sendeve të sekuestruara nga regjistri elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë.

2. Në rast se për vlerësimin e mjeteve të lundrimit dhe të fluturimit, ligji nuk parashikon licencimin e ekspertëve, përmbartuesi gjyqësor, vetëm për nevojat e ekzekutimit, zgjedh persona që kanë njohuri në fusha të veçanta.

3. Eksperti i përzgjedhur kryen vlerësimin vetëm brenda fushës së licencës profesionale apo njohurive të veçanta në fushën e lundrimit ose të

fluturimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 6

Vlera e sendit

1. Për çdo kërkesë të paraqitur, eksperti i fushës përcakton në raportin e vlerësimit vlerën e tregut të sendit objekt vlerësimi.

2. Në rastin e mjeteve të lundrimit e të fluturimit, eksperti përcakton nëse:

- a) janë në gjendje pune ose jo; dhe
- b) mund të vihen në punë, nëse nuk janë në gjendje pune.

3. Nëse mjetet e lundrimit apo të fluturimit nuk mund të vihen në punë, eksperti përcakton vlerën e skrapit.

Neni 7

Metodat e vlerësimit të sendit të paluajtshëm

Vlera e sendit të paluajtshëm përcaktohet nëpërmjet metodave të mëposhtme:

- a) metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë;
- b) metoda e investimit (metoda e kapitalizimit të të ardhurave të investitorit);
- c) metoda e fitimit;
- ç) metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar;
- d) metoda e zhvillimit.

Neni 8

Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë

1. Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë përdoret për vlerësimin e tipave të pronave për të cilat ka informacion të mjaftueshëm mbi shitjet paraardhëse.

2. Kjo metodë analizon shitjet e pronave sa më afër datës së vlerësimit së pronës së sekuestruar dhe i krahason me pronën që vlerësohet.

3. Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë vlerëson vlerën e tregut, duke analizuar çmimet nga shitjet ose qiranë e pronave të ngjashme me pronën objekt vlerësimi, si dhe përshtatjet e vlerave të njësisë, duke marrë parasysh dallimet midis të krahasueshmeve dhe pronës objekt vlerësimi.



4. Besueshmëria që mund t'i jepet çdo të dhënë të krahasueshme rreth çmimit në procesin e vlerësimit përcaktohet duke krahasuar karakteristika të ndryshme të pronave dhe transaksioneve, nga të cilat janë marrë të dhënat me pronën objekt vlerësimi. Në përcaktimin e vlerës së pronës objekt vlerësimi mbahen në konsideratë:

- a) interesi që siguron provën e çmimeve dhe interesi që do të vlerësohet;
- b) vendndodhjet përkatëse;
- c) cilësia përkatëse e tokës ose jetëgjatësia dhe specifikat e ndërtesave;
- ç) përdorimi i lejuar ose zonimi në çdo pronë;
- d) rrethanat në të cilat është përcaktuar çmimi;
- dh) data efektive e çmimeve, prova dhe data e vlerësimit e kërkuar.

5. Në përdorimin e kësaj metode, të dhënat për tregun e shitjeve mund të merren nga zyrtarë noteriale, zyrtarë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agjencitë imobiliare, faqet e internetit dhe në terren, të cilat i bashkëlidhen raportit të vlerësimit, ku evidentohen referencat dhe kushtet e njëjta me pronën që vlerësohet.

6. Gjatë kësaj metode ndiqen hapat kryesorë të mëposhtëm:

- a) investigimi i shitjeve të pronave të krahasueshme, duke grumbulluar të dhëna për prona të krahasueshme lidhur me të dhënat, sipas pikës 4, të këtij neni, si dhe çdo informacion tjetër të mundshëm;
- b) analizimi dhe krahasimi i shitjeve të pronave të krahasueshme me pronën objekt vlerësimi, duke konsideruar të dhënat sipas pikës 3, të këtij neni, dhe faktorët e tjerë që kanë ndikim në vlerën e tregut;
- c) vlerësimi, nëse ndryshimet e konstatuara ndikojnë në çmimin e paguar për pronat krahasuese, duke kryer rregullimet e nevojshme;
- ç) arritja në një përfundim të vlerës së tregut të pronës.

Neni 9

Metoda e investimit

1. Metoda e investimit bazohet në parimin e analizës së vlerës së tashme të përfitimeve të ardhshme.

2. Metoda e investimit përdoret për vlerësimin e pronave të cilat japin të ardhura të vazhdueshme në kohë, duke dhënë vlerën e tregut të shitjes së pronës, ku përfitimi i kësaj prone është në formën e një të ardhure mujore ose vjetore. Kjo metodë bazohet në marrëdhënien midis vlerës, të ardhurave dhe normës së kthimit.

3. Në përdorimin e kësaj metode përdoren të dhënat e kontratave të qirasë të deklaruar në organet tatimore, në zyrtarë noteriale, në zyrtarë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ose të parashikuara nga aktet nënligjore në fuqi që përcaktojnë vlerën e qirasë.

4. Të dhënat e përdorura nga eksperti duhet të jenë sa më afër periudhës së vlerësimit të pronës përkatëse.

Neni 10

Norma e kapitalizimit

1. Në metodën e investimit, zgjedhja e normës së kapitalizimit duhet të jetë e justifikuar.

2. Normat e përdorura të kapitalizimit duhet të pasqyrojnë vlerësimet aktuale të kohës së tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të pronës.

3. Për përcaktimin e vlerës së normës së kapitalizimit, eksperti duhet të mbajë parasysh disa faktorë, duke përfshirë:

- a) vendndodhjen e pronës, duke marrë parasysh çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen;
- b) aspektet fizike të pronës: ndërtimi, cilësia e përfundimeve e të tjera;
- c) modelet e natyrës, gjatësisë dhe rishikimit të qirasë;
- ç) detyrimet e palëve përkatëse në çdo kontratë qiraje;
- d) ligjet dhe rregulloret përkatëse vendëse, që mund të ndikojnë në potencialin për rritje a ulje të qirave gjatë ose në fund të qirasë;
- dh) fuqia e të drejtave të kontraktuara të qiramarrësve.

Neni 11

Metoda e fitimit

1. Metoda e fitimit përdoret për vlerësimin e pronave që kryejnë aktivitet biznesi, përveç



dyqaneve të thjeshta, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) prona është funksionale;

b) të ketë të dhënat e bilanceve të deklaruara pranë organeve tatimore, të paktën për 3 vitet kalendarike të fundit, përpara datës së vlerësimit.

2. Me metodën e fitimit përcaktohet vlera e pronës bazuar në fitimin neto të realizuar, sipas bilancit të 3 viteve të fundit të aktivitetit që zhvillohet në këtë pasuri.

3. Metoda e fitimit bazohet në fitimin neto, duke marrë në konsideratë:

a) të ardhurat totale të realizuar nga aktiviteti i biznesit për 3 vitet e fundit;

b) shpenzimet e aktivitetit për 3 vitet e fundit (kostot e blerjes së mallrave ose ofrimit të shërbimit);

c) fitimin bruto, i cili përllogaritet si diferencë e shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike;

ç) shpenzime të tjera (pagesa si paga, siguracione, ngrohje, ndriçim, reklamë, shërbim telefonik, transport, riparim, si edhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve që mund të bënte një qiramarrës hipotetik).

Fitimi neto llogaritet si diferencë e fitimit bruto me shpenzimet e tjera.

4. Në rast se pronari i pronës kryen edhe aktivitetin ekonomik mbi pronën, nga fitimi neto 50% llogaritet si e ardhur nga qiraja. Kjo vlerë kapitalizohet me një përqindje të arsyeshme kapitalizimi për prona të grupit ku bën pjesë prona objekt vlerësimi, duke përcaktuar në këtë mënyrë vlerën e pasurisë.

5. Në rast se aktiviteti mbi pronën objekt vlerësimi zhvillohet nga një qiramarrës i kontraktuar nga pronari i pasurisë, nga fitimi neto 40% llogaritet si e ardhur nga qiraja. Kjo vlerë kapitalizohet me një përqindje të arsyeshme kapitalizimi për prona të grupit ku bën pjesë prona objekt vlerësimi, duke përcaktuar në këtë mënyrë vlerën e pasurisë.

6. Vlerësimi me anë të kësaj metode përfshin të gjitha elementet që i përkasin njësisë së biznesit, si toka, ndërtimet, pajisjet fikse, instalimet, si dhe çdo gjë që është në funksion të tij dhe nuk mund të ndahet më vete.

7. Në të gjitha rastet, kur ka infrastrukturë nëntokësore dhe linja që janë pjesë përbërëse e pronës merret informacioni për aq sa është e mundur lidhur me markën, tipin, kapacitetin,

numrin identifikues ose matrikulimin, vitin e prodhimit e të tjera.

8. Në rast se pronat përbëhen nga disa pasuri, sipas dokumenteve të pronësisë, por funksioni i tyre lidhet si një e tërë, atëherë ato nuk mund të ndahen apo të shiten në mënyrë të veçantë.

Neni 12

Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar

1. Metoda e kostos së zëvendësimit të amortizuar përdoret për prona, të cilat nuk kanë prova të çmimeve të transaksioneve për prona të ngjashme ose kur nuk mund të identifikohen flukse të ardhurash që do të burojnë për pronarin e pronës objekt vlerësimi.

2. Kjo metodë përdoret parimisht për vlerësimin e pronave specifike, që janë prona që shiten rrallë në treg, përveçse kur shiten me anë të shitjes së biznesit ose njësisë ekonomike ku bëjnë pjesë. Sipas kësaj metode, jepet vlerësimi për vlerën e tregut të tokës, në bazë të shfrytëzimit të saj aktual, shpenzimeve hipotetike të ndërtimit të objekteve të ngjashme me ato ekzistuese, si dhe punimeve përkatëse në truall. Zbritet nga shuma bruto bëhen për të llogaritur çështjet që ndikojnë në vlerën e pronës ekzistuese, krahasuar me pronën zëvendësuese. Zbritja bëhet për faktorë, si amortizimi, vjetërsia, gjendja e vjetërsimi ekonomik dhe funksional.

3. Kostoja e zëvendësimit duhet të reflektojë të gjitha kostot fillestare, si për shembull:

a) vlerën e shpenzimeve për ndërtimin e ndërtesës, sipas çmimeve të punimeve në ndërtim;

b) shpenzimet administrative të lejes së ndërtimit;

c) shpenzimet e hartimit të projektzbatimit (ku përfshihen shpenzimet për arkitektin, konstruktorin, mbikëqyrësin, kolaudatorin, gjeologun).

4. Zgjedhja e normave të amortizimit vlerësohet sipas kushteve dhe gjendjes së pronës objekt vlerësimi, që paraqitet në ditën e vlerësimit.

5. Në amortizimin fizik bëjnë pjesë komponentë, si konsumimi për shkak të përdorimit, moshës, kushteve, lënies pas dore apo edhe të dëmtimeve të qëllimshme.



Amortizimi fizik kategorizohet i korigjueshëm, i cili u referohet kushteve të ndërtesës të cilat ekonomikisht ia vlejnë të korigjohen, si dhe të pakorigjueshëm, i cili u referohet kushteve të ndërtesës kostoja e riparimit e të cilave është më e madhe se e rindërtimit të saj.

6. Amortizim funksional konsiderohet humbja e përdorimit të ndërtesës, e cila përfshin rastet kur disa karakteristika të ndërtesës nuk mund të përdoren më ose nuk përshtaten me vendndodhjen ose ka dëmtime në strukturë, duke ndikuar në humbjen e funksionit të ndërtesës.

7. Zhvlerësim ekonomik konsiderohet zhvlerësimi i pozicionit apo mjedisit dhe lidhet me humbjen e vlerës, për shkak të faktorëve si ndotja mjedisore, ndryshimet e planifikimit urban për përcaktimin e zonave ekonomike, industriale e të tjerë, prania e zhurmave të aeroporteve, linjave të përpunimit të inerteve, përdorimeve të papërshtatshme të tokës në zonën ku ndodhet prona objekt vlerësimi.

8. Përdorimi i kësaj metode kërkon ndër të tjera, njohuri praktike të rregullave aktuale të kontrollit të ndërtesës, kostot e tanishme të ndërtesës dhe të rregulloreve përkatëse për shëndetin e sigurinë.

Neni 13

Metoda e zhvillimit

1. Metoda e zhvillimit përdoret për vlerësimin e të gjitha pronave të cilat kanë potencial zhvillimi apo rihvillimi.

2. Sipas metodës së zhvillimit, vlera e tokës përcaktohet si diferencë e vlerës së tregut të pronës pas zhvillimit me koston e zhvillimit. Në koston e zhvillimit përfshihen shpenzimet e përgjithshme të përmirësimit ose zhvillimit, si dhe fitimi i zhvilluesit të pronës.

Neni 14

Përdorimi i më shumë se një metode vlerësimi

1. Për përcaktimin e vlerës së sendit objekt vlerësimi, ekspert i fushës mund të përdorë edhe kombinime të metodave të vlerësimit, në varësi të karakteristikave të sendit dhe informacionit në treg për sende të ngjashme.

2. Eksperti duhet t'i marrë në konsideratë rezultatet e ndryshme dhe të japë një gjykim profesional sa i takon vlerës që duhet raportuar.

Neni 15

Metodat për vlerësimin e mjeteve të lundrimit e të fluturimit

1. Vlera e mjetit të lundrimit ose të fluturimit përcaktohet nga eksperti i fushës, duke përdorur metodën e krahasimit të shitjeve, duke zbritur vlerën e amortizimit të akumuluar ose humbjet nga dëmtimi i akumuluar, ose në rastet kur mjeti i lundrimit apo fluturimit është plotësisht jashtë funksionit për shkak të dëmtimit, jepet vlera e skrapit.

2. Për mjetet e lundrimit e të fluturimit të dhënat e tregut duhet të jenë të paktën të tre muajve të fundit përpara datës së vlerësimit.

Neni 16

Metodologjia për vlerësimin e mjeteve të lundrimit e të fluturimit

1. Eksperti i fushës nuk mund të angazhohet për vlerësimin e mjeteve të lundrimit ose të fluturimit, në mungesë të procesverbalit të sekuestrimit sipas neneve 561 dhe 562 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Vendimi i përmbarduesit gjyqësor për caktimin e ekspertit duhet të përmbajë të gjitha të dhënat për mjetin e sekuestruar së bashku me dokumentacionin përkatës që provon pronësinë e këtyre mjeteve.

3. Eksperti përcakton vlerën e tregut dhe vlerësimi kryhet në bazë të çmimeve të tregut për sende të ngjashme e të krahasueshme, nëse në ditën e inspektimit janë në gjendje pune.

4. Në rastet ku mjetet e lundrimit ose të fluturimit nuk janë në gjendje pune ose kanë dalë jashtë funksionit për shkak të dëmtimit, eksperti përcakton vlerën e skrapit.

Neni 17

Inspektimi i sendit

1. Eksperti i fushës deklaron në raportin e vlerësimit se ka kryer personalisht inspektimin e sendit të paluajtshëm, të mjetit të lundrimit ose të fluturimit, si dhe konfirmon se ka kryer një



inspektim të plotë të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të sendit.

2. Nëse çmohet e nevojshme nga eksperti, palët mund të jenë pjesë e inspektimit.

Neni 18

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Ekspertit, bashkë me vendimin e përmbartuesit gjyqësor për caktimin e tij, i vendosen në dispozicion dokumentet e mëposhtme:

a) Për pasuritë e paluajtshme:

i. certifikata e pronësisë, kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit, në momentin e vendosjes së sekuestrës;

ii. planvendosja dhe planimetria e regjistrimit të sendit në regjistrat publikë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me numrin përkatës të referencës që përbëjnë edhe dokumentet teknike të pronës;

iii. çdo dokument tjetër teknik që çmohet i nevojshëm nga eksperti për vlerësimin e sendit.

b) Për mjetet e lundrimit e të fluturimit:

i. dokumenti i regjistrimit në regjistrat publikë përkatës;

ii. dokumenti nga regjistri i barrës siguruese;

iii. dokumente të blerjes së tyre;

iv. kopja e procesverbalit të sekuestrimit;

v. leja e qarkullimit;

vi. fatura doganore;

vii. çdo dokument tjetër teknik që çmohet i nevojshëm nga eksperti për vlerësimin e mjetit.

2. Vlerësimi bazohet vetëm mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion të ekspertit, sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 19

Raporti i vlerësimit për sendet e paluajtshme

1. Raporti i vlerësimit për sendet e paluajtshme paraqitet me shkrim, në përputhje me standardet profesionale dhe sipas kësaj metodologjie.

2. Raporti i vlerësimit përmban:

a) të dhëna në lidhje me palët në procesin e ekzekutimit dhe përmbartuesin gjyqësor;

b) emrin, mbiemrin, adresën dhe kualifikimet e ekspertit të fushës;

c) adresën e pronës;

ç) datën e vlerësimit dhe personat e pranishëm gjatë inspektimit;

d) qëllimin e raportit të vlerësimit;

dh) konformitetin me standardet;

e) supozimet e mundshme mbi të cilat bazohet vlerësimi i sendit të sekuestruar;

ë) një përshkrim të vendndodhjes së pronës (të shoqëruar me të dhëna mbi infrastrukturën, mirëmbajtjen, transportin, aksesin nga autostrada, rrugët, hekurudha, autobusët, aeroporte, porte, e të tjera);

f) përshkrimin e nivelit socioekonomik, konsolidimin, jetën ekonomike dhe të përdorimit të pronës, rinovimin, trafikun, parkingun:

i. ndërtesa: përshkrimi, identifikimi fizik, tipologjia, vendndodhja, katet nën/mbi tokë, përdorimi për kat, pamja e përgjithshme, kopshti, parkimi i ndërtesës, kompanitë ndërtuese, moshë e rikonstruksionit, cilësia e ndërtimit, themelet, struktura, mbulesa, fasada;

ii. pjesa e brendshme: fleksibiliteti, ndriçimi, pamjet, dhoma kryesore, struktura, ana funksionale;

iii. rifiniturat: dyshemetë, muret, tavanet, punimet e jashtme me dru, punimet e brendshme me dru;

iv. pajisjet e shërbimit, instalimet: ujë i ngrohtë, pajisjet hidrosanitare, ashensorët, ngrohja, ajri i kondicionuar, tipi, ruajtja, mbrojtja nga zjarri, hidrantët e zjarrit, alarmi, dritat e emergjencës, sektorizimi, zbulimi, shuarja, aparatet kundër vjedhjeve, hyrja, recepsioni/portieri, kontrolli, energjia, telefoni, gazsjellësi, gaz i natyror, fibrat optike, gjeneratori, depozitat e ujit, e të tjera;

g) sipërfaqet e tokës dhe ndërtesës për çdo kat:

i. kontrolli i sipërfaqeve: përputhja e planimeve me realitetin, matja dhe kontrolli i sipërfaqeve, sipërfaqja e ndërtuar, sipërfaqja bruto, sipërfaqja e shfrytëzueshme, sipërfaqja e regjistruar;

gj) ndryshimet e konstatuara mes gjendjes juridike dhe faktike të pronës si rezultat i ballafaqimit të dokumentacionit ligjor me gjendjen faktike nga inspektimit.

h) kushtet, shërbimet dhe planifikimi urban, zhvillimi urban, transporti, përdorimet e tokës, zona e monumenteve të mbrojtura;



- i) një koment mbi gjendjen aktuale të tregut të pronës: kërkesa, oferta, trendi;
 - j) të dhënat e tregut;
 - k) një përshkrim të metodës dhe analizën e vlerësimit të kryer;
 - l) vlerën e tregut dhe llogaritjen e saj sipas metodës së përzgjedhur;
 - ll) dokumentet e nevojshme të përdorura për vlerësimin e sendit;
 - m) harta satelitore e vendndodhjes së sendit makro dhe mikro zonë;
 - n) planvendosja dhe planimetria e sendit, sipas gjendjes faktike dhe matjeve;
 - o) foto të sendit me datën e vlerësimit, të të gjitha pamjeve dhe për secilin ambient të brendshëm.
3. Raportit të vlerësimit i bashkëlidhen:
- a) vendimi i caktimit të ekspertit nga ana e përmbartuesit gjyqësor;
 - b) deklarata e ekspertit, se:
 - i. njeh dhe zbaton këtë metodologji;
 - ii. nuk është i dënuar nga organet gjyqësore në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit të sendeve;
 - c) deklarata e betimit të ekspertit;
 - ç) fotokopje të licencës së ekspertit;
 - d) dokumentacioni tekniko-ligjor që vërteton marrjen e të dhënave në treg nga eksperti.

Neni 20

Raporti i vlerësimit për mjetet e lundrimit e të fluturimit

1. Raporti i vlerësimit për mjetet e lundrimit e të fluturimit duhet të paraqitet me shkrim, në përputhje me standardet profesionale dhe sipas kësaj metodologjie.
2. Raporti i vlerësimit përmban:
- a) të dhëna në lidhje me palët në procesin e ekzekutimit dhe përmbartuesin gjyqësor;
 - b) emrin, mbiemrin, adresën dhe kualifikimet e ekspertit të fushës;
 - c) adresën ku ndodhet sendi;
 - ç) datën e vlerësimit dhe personat e pranishëm gjatë inspektimit;
 - d) qëllimin e raportit të vlerësimit;
 - dh) një përshkrim të vendndodhjes së sendit:
 - i. vendndodhja;
 - ii. përshkrimi;

- e) një përmbledhje të kontekstit ligjor (pronësia, qiramarrësit etj.);
- ë) një koment mbi gjendjen aktuale të tregut të sendit: kërkesa, oferta, trendi;
- f) të dhënat e tregut;
- g) një përshkrim të metodës dhe analizën e vlerësimit të kryer;
- gj) konfirmim nga eksperti nëse mjetet e vlerësuara mund të ndryshojnë vendndodhje, pra të zhvendosen dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes duhet të jepen dhe të zbriten nga vlerat e raportuara;
- h) vlerën e tregut dhe llogaritjen e tyre sipas kësaj metodologjie;
- i) dokumentet e nevojshme të paraqitura për vlerësimin e sendit;
- j) hartën satelitore të vendndodhjes së sendit makro dhe mikro zonë;
- k) foto të sendit me datën e vlerësimit, të të gjitha pamjeve dhe për secilin ambient të brendshëm;
- l) deklaratën e ekspertit, që:
 - i. njeh dhe zbaton këtë metodologji;
 - ii. vërtetimin se nuk është i dënuar nga organet gjyqësore në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit të sendeve;
- ll) fotokopje të licencës së ekspertit ose dokumentin që provon njohuritë e veçanta në fushën e lundrimit ose të fluturimit;
- m) deklaratën e betimit;
- n) vendimin e caktimit të ekspertit nga ana e përmbartuesit gjyqësor.

Neni 21

Supozime të lejuara në raportin e vlerësimit

- Eksperti i licencuar mund të paraqesë një raport vlerësimi me shkrim me supozimet, si më poshtë vijon:
- a) dokumentet e pronësisë të paraqitura janë të rregullta, ligjore dhe të sakta;
 - b) vlera përfshin kontributin e tokës dhe të aseteve fikse me pronën sipas statusit ligjor të saj;
 - c) gjatë ndërtimit dhe më vonë nuk janë përdorur materiale të dëmshme dhe të rrezikshme;
 - ç) prona është regjistruar sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi;



d) kërkimet në zyrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nuk prekin vlerën e pronës së raportuar.

Neni 22

Nëse mbi sendin që vlerësohet janë realizuar shtesa pa leje, këto të fundit nuk përbëjnë objekt vlerësimi.

Neni 23

1. Për makineri, pajisje apo linja të lidhura me furnizimin ose të cilat ofrojnë shërbime utilitare në një ndërtesë dhe janë të integruara brenda saj, si linja furnizimi me energji, gaz, ujë, ngrohje, ventilim, ashensor, vlerësimi kryhet duke i përfshirë këto në vlerën e sendit sipas tregut.

2. Në këtë rast, eksperti deklaron në raport se ka përfshirë në vlerësim edhe vlerën e makinerive, pajisjeve apo linjave. Eksperti duhet të argumentojë me shkrim pamundësinë e shkëputjes së tyre nga ndërtesa për shkak se shkaktohen dëme të konsiderueshme.

3. Nëse për makineritë, pajisjet apo linjat të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kërkohet vlerësimi veçmas i tyre, duhet të jepet me shkrim në detyrat që i ngarkohen ekspertit të fushës.

VENDIM

Nr. 971, datë 2.12.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR POLITIKAT E PËRGJITHSHME SHTETËRORE, PËR SISTEMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 92, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë, në

respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe garantimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë.

2. Politikat, strategjitë dhe objektivat sektoriale për sistemet e teknologjisë së informacionit, të institucioneve të sistemit të drejtësisë, mbështeten dhe zhvillohen të harmonizuara me politikat, strategjitë dhe objektivat e përgjithshme shtetërore për sistemet e teknologjisë së informacionit, si dhe në përputhje me kompetencat, funksionet, nevojat institucionale, masat mbrojtëse që sigurojnë akses vetëm për institucionet e sistemit të drejtësisë, përveç rasteve kur të dhënat janë me natyrë statistikore ose kur parashikohet ndryshe në ligj, financimin e qëndrueshëm, ofrimin e sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, si dhe garantimin e burimeve njerëzore.

3. Institucionet e sistemit të drejtësisë, në zhvillimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, garantojnë komunikim dhe shkëmbim efektiv e të sigurt të të dhënave dhe të informacionit brenda kufijve të caktuar me ligj, duke ndërmarrë masat, si më poshtë vijon:

a) zhvillimin e një strategjie/plani bashkëpunimi për të lejuar komunikimin midis sistemeve;

b) përcaktimin e standardeve teknike për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e automatizuar të tyre, si dhe për prodhimin e statistikave përkatëse.

4. Sistemet e teknologjisë së informacionit projektohen me arkitekturën (*hardware* dhe *software*), për të mundësuar komunikimin, administrimin dhe mirëmbajtjen, sipas nevojave specifike për çdo institucion të sistemit të drejtësisë.

5. Institucionet e sistemit të drejtësisë përcaktojnë procedurat për monitorimin dhe kontrollin ndaj rreziqeve të mundshme që vijnë nga keqpërdorimi ose mosfunksionimi i sistemeve të informacionit.

6. Sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit dizajnohen, programohen dhe ndërtohen për të siguruar prodhimin e statistikave nëpërmjet mbledhjes së të dhënave rreth funksionimit të institucioneve të drejtësisë, me fokus eficiencën dhe llogaridhënien e tyre.

7. Projektet e teknologjisë duhet të përmbushin standarde të posaçme, që garantojnë parimet ergonomike, kushtet për nënshkrimet elektronike, shkëmbimin e dokumenteve (përputhshmërinë e sistemeve), strukturën e dokumenteve, certifikimin



e dokumenteve, indeksimin e dokumenteve, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe detyrimin për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit të akteve hetimore.

8. Institucionet e sistemit të drejtësisë bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse shtetërore, lidhur me aspektet me ndikim buxhetor, për të siguruar planifikim financiar të qëndrueshëm, për sistemin e teknologjisë së informacionit.

9. Projektet e teknologjisë së informacionit përmbushin nevojat e sigurisë teknike dhe operative për çdo institucion të drejtësisë, veçanërisht për sigurinë kibernetike, integritetin, paprekshmërinë dhe mbrojtjen e sistemeve dhe të bazave të të dhënave shtetërore.

10. Institucionet e sistemit të drejtësisë, sipas kompetencave të tyre, marrin masa për sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke analizuar periodikisht riskun për të gjitha aplikacionet kompjuterike, si dhe për mënyrën e administrimit të këtyre aplikacioneve dhe pajisjeve kompjuterike.

11. Sistemet e teknologjisë së informacionit në institucionet e drejtësisë mundësojnë gjurmimin e informacioneve dhe të komunikimit, për të monitoruar respektimin e rregullave e të procedurave.

12. Institucionet e sistemit të drejtësisë marrin masa për t'i dhënë akses institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të tjera të parashikuara me ligj dhe në përputhje me nevojat e ushtrimit të kompetencave të tyre. Akses i jepet:

a) i plotë, sipas ligjit, në sistemet e teknologjisë së informacionit që administrojnë institucionet e sistemit të drejtësisë, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;

b) i nevojshëm, në nivelin vizitor, për të prodhuar të dhënat statistikore, për Ministrinë e Drejtësisë, në përputhje me nevojat dhe politikat e ndërmarra në fushën e drejtësisë;

c) për qëllime të veprimtarisë hetimore, për organet e ushtrimit të ndjekjes penale;

ç) bazuar mbi kërkesa të justifikuar dhe të pranuar nga administruesi i sistemit, të institucioneve ekzistuese apo të krijuara në vijim, për nevoja të përmbushjes së kompetencave të tyre.

13. Bashkëpunimi institucional, përmes Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, garanton koordinimin dhe mbështetjen administrative, financiare e logjistike,

si dhe funksionimin e sigurt dhe efektiv të sistemit të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

14. Institucionet e sistemit të drejtësisë marrin masa për të rekrutuar personel të kualifikuar dhe që i nënshtrohet trajnimeve të vazhdueshme, për qëllime të garantimit e ruajtjes së integritetit, të disponueshmërisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave që përmban sistemi i teknologjisë.

15. Institucionet e sistemit të drejtësisë hartojnë manuale të qarta dhe të kuptueshme për përdorimin e sistemeve, për çdo punonjës që do të ketë rol në përdorimin e sistemit të teknologjisë së informacionit.

16. Ngarkohen Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, dhe institucionet e sistemit të drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 972, datë 2.12.2020

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN E
PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË
QENDRËS SË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT PËR SISTEMIN E
DREJTËSISË**

Në mbështetje të neneve 100, 147/a, pika 1, shkronja “d”, e 148/b, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 92, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (në vijim qendra).

2. Qendra është institucion publik buxhetor, që gëzon personalitet juridik, me seli në Tiranë. Qendra ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit të



Lartë Gjyqësor, i cili siguron ambientet e përshtatshme të punës për të. Funksionet mbështetëse horizontale administrative, financiare e logjistike kryhen për qendrën nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Për qëllime të këtij vendimi, institucione të sistemit të drejtësisë janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të gjitha gjykatat e caktuara me ligj, përfshirë Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të gjitha prokuroritë e caktuara me ligj, përfshirë Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.

4. Qendra financohet nga buxheti i shtetit si një program buxhetor i veçantë në buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Misioni i qendrës është caktimi i standardeve dhe i politikave, në përputhje me rregullat për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë, për një funksionim efektiv të sistemeve të teknologjisë së përpunimit të informacionit dhe të të dhënave (pajisje dhe programe), duke siguruar përmbushjen e nevojave të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Qendra nuk ka akses të drejtpërdrejtë në sistemet e teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

6. Qendra, në përmbushjen e veprimtarisë së saj, bazohet në këto parime:

a) garantimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe ndarja e pushteteve;

b) garantimi i sigurisë dhe i integritetit të të dhënave në sistemet e teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë;

c) mbrojtja e të dhënave personale dhe garantimi i konfidencialitetit;

ç) ruajtja e sekretit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore;

d) garantimi i ndërveprimit dhe i shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë;

dh) garantimi i prodhimit dhe i shpërndarjes së statistikave ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë;

e) garantimi i zbatimit të standardeve të Bashkimit Evropian për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

7. Aktet e nxjerra nga qendra janë të detyrueshme për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

8. Qendra organizohet dhe ushtron funksionet nëpërmjet organeve drejtuese, si më poshtë vijon:

a) Drejtori ekzekutiv;

b) Bordi drejtues.

Në ushtrimin e funksioneve të saj, qendra mbështetet nga ekipi këshillimor i ekspertëve, si organ këshillimor i Bordit drejtues dhe nga struktura e përhershme e ngritur sipas shkronjës “a”, të pikës 10, të këtij vendimi.

9. Bordi drejtues është organ kolegjal vendimmarrës, që kryesohet nga kryetari i Bordit dhe ka në përbërje 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë me të drejtë vote, si vijon:

a) një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i caktuar nga mbledhja plenare;

b) një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i caktuar nga mbledhja plenare;

c) një përfaqësues nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

ç) një përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës;

d) një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme;

dh) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;

e) një përdorues fundor që përfaqëson Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;

ë) një përdorues fundor nga prokuroritë e shkallëve të ndryshme;

f) dy përdorues fundor nga gjykatat e shkallëve të ndryshme;

g) një përdorues fundor nga gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

9.1 Përdoruesi fundor nga prokuroritë e shkallëve të ndryshme zgjidhet nga Prokurori i Përgjithshëm, nga kandidaturat e propozuara nga drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

9.2 Përdoruesi fundor i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar zgjidhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas propozimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

9.3 Përdoruesit fundor nga gjykatat e shkallëve të ndryshme zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga kandidaturat e propozuara nga kryetarët e gjykatave.

9.4 Përdoruesi fundor nga gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar



zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga kandidaturat e propozuara nga të dy kryetarët e gjykatave të posaçme.

9.5 Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë pjesë personalisht ose, në pamundësi, përmes një inspektori të autorizuar.

9.6 Përfaqësuesi i Shkollës së Magjistraturës është kancelari, i cili merr pjesë personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar.

9.7 Përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme është sekretari i Përgjithshëm, i cili merr pjesë personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar.

9.8 Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë është sekretari i Përgjithshëm, i cili merr pjesë personalisht ose përmes një përfaqësuesi të autorizuar.

10. Bordi drejtues ushtron kompetencat e tij në zbatim të politikave të përgjithshme shtetërore për përmbushjen e nevojave të veçanta të sigurisë, teknike dhe operative, për çdo institucion të sistemit të drejtësisë, duke treguar kujdes të veçantë për sigurinë kibernetike, integritetin e mbrojtjes së sistemit dhe të të dhënave të përdorura e të ruajtura nga sistemi. Bordi ushtron kompetencat, si më poshtë vijon:

a) propozon strukturën e organikën e qendrës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) miraton projektbuxhetin e qendrës;

c) miraton rregulloren e brendshme për organizimin e funksionimit të Qendrës;

ç) emëron drejtorin ekzekutiv në përfundim të procedurës së realizuar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

d) përcakton rregullat e udhëzimet për institucionet e sistemit të drejtësisë lidhur me hapat dhe masat që duhet të merren për teknologjinë e informacionit në sistemin e drejtësisë, me qëllim sigurimin e ndërveprimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit;

dh) vendos për masat më të larta mbrojtëse që përcaktojnë aksesin e secilit institucion, bazuar në rolin e secilit prej tyre, në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe të të dhënave. Aksesin e bazuar në rolin e institucionit duhet të përcaktohet nga rrjedha e proceseve të punës e nevojat operative të punës së çdo institucioni. Ky lloj aksesit duhet të krijohet për secilën teknologji informacioni dhe/ose sistem të dhënash brenda çdo institucioni;

e) përcakton rregulla dhe procedura përmes të cilave Inspektori të Lartë të Drejtësisë i garantohet aksesin e plotë, pa të drejtë modifikimi/ndërhyrjeje në sistemet e të dhënave dhe të teknologjisë së informacionit, siç parashikohet në ligj;

ë) miraton rregullat e procedurat përmes të cilave garantohet mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale, si dhe ruajtja e sekretit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore, ndërkohë që garantohet edhe e drejta për një proces të rregullt;

f) miraton rregullat e procedurat për dhënien e aksesit të sigurt, nga autoritetet publike, të parashikuara nga ligji apo vendimet e Këshillit të Ministrave, për organet proceduese gjatë kryerjes së hetimit e të ushtrimit të ndjekjes penale;

g) miraton protokollet për mbledhjen, përdorimin e shkëmbimin e të dhënave;

gj) miraton masa që sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit të gjenerojnë informacionin statistikor që nevojitet për punën e të gjitha institucioneve në sistemin e drejtësisë, në konsultim të ngushtë me institucionet përkatëse;

h) miraton strategjinë e përgjithshme dhe vizionin lidhur me teknologjinë e informacionit për institucionet e sistemit të drejtësisë, si dhe miraton plane strategjike afatgjata për teknologjinë;

i) miraton arkitekturën e strukturën e sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet e miratuara;

j) mbikëqyr zbatimin e specifikimeve teknike për sistemet e teknologjisë së informacionit të sistemit të drejtësisë;

k) informon institucionet e sistemit të drejtësisë, çdo vit, lidhur me gjendjen e përdorimit e të funksionimit të sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit;

l) siguron që institucionet e sistemit të drejtësisë kryejnë, përmes një ekspertize të kualifikuar e të pavarur, auditimin e bazave të tyre të të dhënave;

ll) përcakton prioritetet në drejtim të investimit e të zbatimit të projekteve të reja;

m) miraton të gjitha nismat që lidhen me teknologjinë e informacionit, së bashku me buxhetet përkatëse;

n) miraton politikat që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përgjegjëse për teknologjinë e informacionit, në institucionet e sistemit të drejtësisë, si dhe politikat për pajisjet e



teknologjisë së informacionit e programet kompjuterike që përdoren nga institucionet e sistemit të drejtësisë;

n) përcakton standardet e politikat për prokurimin e mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve të teknologjisë së informacionit, të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike, si dhe të shërbimeve të internetit e intranetit;

o) siguron që prokurimet dhe kontratat e institucioneve të sistemit të drejtësisë, për zhvillimin e mirëmbajtjen e të gjitha sistemeve të teknologjisë së informacionit, të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike, si dhe për shërbimet e internetit, edhe intranetit, kryhen në përputhje me standardet e politikat e miratuara;

p) vlerëson e miraton paraprakisht të gjitha marrëveshjet që mund të lidhin institucionet e sistemit të drejtësisë me persona fizikë, juridikë, publikë ose privatë, si dhe me organizatat jofitimprurëse, të cilët kanë ndikim në funksionimin e teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të të dhënave;

q) siguron menaxhimin, funksionimin e mirëmbajtjen e besueshme dhe të sigurt të sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve të sistemit të drejtësisë;

r) vendos rregulla për administrimin e të gjitha sistemeve të teknologjisë së informacionit e miraton udhëzime për përdorimin e tyre.

11. Në rast se vendimmarrja për politikat e standardet lidhur me sigurinë, integritetin e bazës së të dhënave shtetërore ose të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, aksesin, shkëmbimin ose ndërveprimin e të dhënave, vlerësohet se përmbush prapen e nevojave të të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë, përveç Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe/ose gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, anëtarët e Bordit drejtues që përfaqësojnë këto institucione mund të propozojnë vendimmarrje të veçantë, e cila adreson nevojat unike të këtyre institucioneve. Bordi drejtues pranon propozimin e merr vendim të veçantë në përputhje me të. Këto vendime përcaktojnë në mënyrë të shprehur kufizimin e zbatimit vetëm nga struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe/ose gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

12. Bordi drejtues mbledhet të paktën 1 (një) herë në muaj. Kryetari i Bordit mund të thërrasë mbledhje më të shpeshta, nëse ka çështje që duhet të trajtohen.

13. Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 7 (shtatë) anëtarë. Kur kuorumi nuk plotësohet, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër. Bordi vendos në votim të hapur me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Anëtar i Bordit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, përveçse kur ka konflikt interesi ose pengesa të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kryetari është anëtar i fundit i cili voton lidhur me një çështje. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Çdo anëtar i Bordit mban përgjegjësi për votën dhe ka të drejtë të bëjë një deklaram të shkurtër me gojë ose me shkrim për arsyet e votimit.

14. Kryetari i Bordit drejtues kryen këto funksione:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjet e Bordit;

b) mbikëqyr mbështetjen e nevojshme administrative, financiare dhe logjistike nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për funksionimin e qendrës;

c) në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe strukturën e përhershme të qendrës, siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e Bordit;

ç) siguron që mbledhja e Bordit të regjistrohet në sistemin audio dhe një përmbledhje e procesverbalit të mbledhjes së Bordit bëhet publike në faqen e internetit të qendrës;

d) drejton procesin e shpërndarjes së detyrave ndërmjet anëtarëve të Bordit;

dh) drejton procesin e hartimit e të zbatimit të planit vjetor të Bordit dhe siguron publikimin e tij;

e) siguron dorëzimin e projektbuxhetit të qendrës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda afatit dhe merr pjesë në diskutimet e Kuvendit për buxhetin e sistemit gjyqësor;

ë) siguron dokumentimin e mbledhjes së Bordit e mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

f) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me vendim të Bordit ose nga legjislacioni në fuqi.

15. Kryetar i Bordit drejtues është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa zëvendëskryetar i tij është anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.



16. Zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e kryetarit në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme të kryetarit.

17. Marrëdhëniet e punës së drejtorit ekzekutiv dhe të nëpunësve të qendrës rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

18. Drejtori ekzekutiv i qendrës emërohet sipas dispozitave të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil dhe të këtij vendimi. Përveç kërkesave të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil dhe kërkesave të posaçme të përcaktuara në përshkrimin e punës, drejtori ekzekutiv i qendrës duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë profesionale në sektorin e teknologjisë së informacionit.

19. Drejtori ekzekutiv ushtron kompetencat dhe kryen këto detyra:

a) përfaqëson qendrën në marrëdhëniet me palët e treta;

b) menaxhon veprimtarinë e qendrës dhe të nëpunësve të saj;

c) kujdeset për dokumentimin e të gjitha mbledhjeve të Bordit dhe publikimin e tyre, sipas udhëzimeve të kryetarit të Bordit;

ç) udhëzon e bashkëpunon me njësinë e burimeve njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor për hartimin e përshkrimeve të punës, sipas specifikave të çdo pozicioni pune;

d) udhëzon e bashkëpunon me njësinë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për hartimin e projektbuxhetit të qendrës dhe siguron dorëzimin në kohë të tij në Bord;

dh) harton rregulloren e brendshme për organizimin e funksionimit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe ia propozon Bordit për miratim;

e) kryen detyrat e drejtuesit të “njësisë përgjegjëse”, në kuptim të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar në legjislacionin në fuqi apo me vendim të Bordit.

20. Ekipi këshillimor i ekspertëve krijohet e kryen veprimtarinë e tij pranë qendrës. Ekipi këshillimor thirret nga kryetari i Bordit për të trajtuar çështje specifike, sipas nevojës së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe përbëhet nga:

a) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor;

b) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

c) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

ç) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit në Shkollën e Magjistraturës;

d) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme;

dh) nëpunësi më i lartë përgjegjës për çështjet e statistikave në Ministrinë e Drejtësisë;

e) drejtori ekzekutiv i qendrës.

21. Qendra ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

22. Vula e qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit e të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

23. Struktura dhe organika e qendrës miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas propozimit të Bordit drejtues.

24. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar në qendër, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

25. Ngarkohen, përkatësisht, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm për organizimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve fundorë, sipas parashikimit të pikës 9, të këtij vendimi.

26. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i qendrës, si një program buxhetor më vete, brenda buxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



27. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1.1.2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 975, datë 2.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 641, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR EKSPORTIN E MBETJEVE DHE KALIMIN TRANZIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME E TË MBETJEVE INERTE”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim, fjalët “Kopjen e lejes së mjedisit të tipit “A”, “B” ose “C”, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar”, zëvendësohen me fjalët “Kopjen e lejes së mjedisit të tipit “A” ose “B”, nëse aktiviteti është i përcaktuar në shtojcën 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.”.

2. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kërkesën, në të cilën shprehen e përcaktohen qartë:

i. të dhënat e personit fizik/tregtarit apo të personit juridik;

ii. një përshkrim i mbetjeve që do të eksportohen, ku të përcaktohen lloji i mbetjeve, sipas kodit tarifor, dhe sasia, e cila duhet të jetë në përputhje me sasinë e përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet palëve dhe me pikën 5 të formularit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

iii. vendi i origjinës së mbetjeve, vendi i destinacionit final të mbetjeve dhe vendet e kalimit tranzit;

iv. mjetet e transportit të mbetjeve të rrezikshme, të pajisura me certifikatën e miratimit të mjetit, sipas ADR-së, në zbatim të ligjit nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, nëse këto mbetje përfshihen në aneksin A të ADR-së;

v. mënyra e paketimit dhe/ose ambalazhimit dhe etiketimit të mbetjeve.”.

b) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe, të kontratës së lidhur ndërmjet personit fizik/tregtarit apo personit juridik që eksporton dhe atij që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre. Kontrata të jetë efektive që nga data e aplikimit për autorizimin për eksport deri në përfundim të vlefshmërisë së autorizimit, për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave të mbetjeve. Në kontratën e lidhur ndërmjet palëve të përcaktohet sasia e mbetjeve që do të eksportohet.”.

c) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në të cilin tregohet edhe sasia e mbetjeve për t’u eksportuar, siç përcaktohet në kontratën sipas parashikimit në shkronjën “d”, të kësaj pike. Formulari duhet të përmbajë, në hapësirat përkatëse, firmën e vulën origjinale të personit fizik/tregtarit apo të administratorit të personit juridik.”.

ç) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Faturën e garancisë financiare apo të sigurimit ekuivalent, sipas përcaktimit në pikën 20, të këtij vendimi. Garancia duhet të jetë efektive për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave.”.

d) Në pikën 16 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

¹ Përafruar pjesërisht me rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 1013/2006/EC, datë 14.6.2006, “Për transfertat e mbetjeve GZ L 190, datë 12.7.2006”, CELEX 32006R1013. Faqe| 16406



“a) Kërkesën, në të cilën shprehen dhe përcaktohen qartë:

i. të dhënat e personit fizik/tregtarit apo të personit juridik;

ii. një përshkrim i mbetjeve që do të eksportohen ku të përcaktohen lloji i mbetjeve, sipas kodit tarifor, dhe sasia e mbetjeve, e cila duhet të jetë në përputhje me sasinë dhe llojin e përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet palëve dhe me pikën 3 të formularit, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

iii. vendi i origjinës së mbetjeve, vendi i destinacionit final të mbetjeve dhe vendet e kalimit tranzit;

iv. mjetet e transportit të mbetjeve; si dhe

v. mënyra e paketimit dhe/ose ambalazhimit dhe etiketimit të mbetjeve.”.

ii. Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të kontratës së lidhur ndërmjet personit fizik/tregtarit apo personit juridik dhe atij që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre. Kontrata të jetë efektive që nga data e aplikimit për autorizimin për eksport deri në përfundim të vlefshmërisë së autorizimit, për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave të mbetjeve. Në kontratën e lidhur ndërmjet palëve të përcaktohet sasia e mbetjeve që do të eksportohet.”.

iii. Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi, ku tregon edhe sasinë e mbetjeve për t’u eksportuar, siç paraqitet në kontratën sipas shkronjës “d”. Formulari përmban, në hapësirat përkatëse, firmën dhe vulën origjinale të personit fizik/tregtarit apo të administratorit të personit juridik.”.

iv. Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të lejes/autorizimit/licencës të lëshuar nga autoriteti kompetent i destinacionit, që provon se subjekti që merr në dorëzim mbetjet, ushtron ligjërisht në vendin e tij veprimtarinë për të cilën kryhet transferta, siç përcaktohet në kontratën ndërmjet palëve. Leja/autorizimi/licenca të jetë efektive për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave.”.

v. Shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Faturën e garancisë financiare apo të sigurimit ekuivalent, sipas përcaktimit në pikën 20,

të këtij vendimi. Garancia të jetë efektive për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave.”.

dh) Në pikën 25 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kërkesën, në të cilën shprehen dhe përcaktohen qartë:

i. të dhënat e personit fizik/tregtarit apo të personit juridik;

ii. një përshkrim i shkurtër i mbetjeve që do të tranzitohen, ku të përcaktohen lloji i mbetjeve, sipas kodit tarifor, dhe sasia, e cila duhet të jetë në përputhje me sasinë e përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet palëve dhe me pikën 3 të formularit, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi;

iii. vendi nga i cili merret sasia e mbetjeve;

iv. pika kufitare e hyrjes dhe e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe shtetet nëpër të cilat do të kalojë mjeti me të cilin do të transportohen mbetjet.”.

ii. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kopjen e noterizuar të përkthimit në gjuhën shqipe të kontratës së lidhur ndërmjet personit fizik/tregtarit apo personit juridik dhe atij që merr në dorëzim mbetjet për menaxhimin e integruar të tyre. Kontrata të jetë efektive që nga data e aplikimit për autorizimin për eksport deri në përfundim të vlefshmërisë së autorizimit, për të gjithë kohëzgjatjen e transfertave të mbetjeve. Në kontratën e lidhur ndërmjet palëve të përcaktohet sasia e mbetjeve që do të eksportohet.”.

iii. Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Formularin e plotësuar, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi, ku tregohet edhe sasia e mbetjeve për t’u eksportuar, siç përcaktohet në kontratën sipas shkronjës “b”. Formulari të përmbajë, në hapësirat përkatëse, firmën dhe vulën origjinale të personit fizik/tregtarit apo të administratorit të personit juridik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

**UDHËZIM****Nr. 25, datë 1.12.2020****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019,
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET
E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi”, zëvendësohet me togfjalëshin “sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik”.

b) në pikën 18 të kreut IV/4, togfjalëshi “... brenda datës 30 nëntor ...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... brenda datës 15 dhjetor ...”.

c) pika 1 dhe 1.1 të kreut V, ndryshojnë, si më poshtë:

“1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë shkresore dhe elektronike:

a) brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve shtetas të huaj në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, “Master ekzekutiv”, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

d) Pas pikës 4, të kreut V, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

“4/1. Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, përjashtimisht për vitin akademik 2020–2021, ngarkohen të ndryshojnë kalendarin, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në



programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional”/“Master i shkencave”/“Master i arteve”, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, deri në datë 15.12.2020.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi

NDREQJE GABIMI

Në vendimin nr. 67/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193/2020, datë 9.11.2020, në lidhjen nr. 2 bëhet ndreqja, si më poshtë vijon:

Në kolonën KATEGORIA/KLASA, pozicioni “Nënkomisioner”, para fjalëve: “ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor”, i ndryshuar”, shtohen fjalët: “80% e pagës së Komisionerit sipas përcaktimit në”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë